





Si të mbrohemi ndaj viruseve siç është Koronavirusi COVID-19 ose gripi i i stinës?



1. Nëse jeni sëmurë, qëndroni në shtëpi.
2. Lani duart rregullisht.
3. Përdorni gjithmonë peceta (shami) të reja prej letre dhe i hidhni ato në një kosh me kapak të mbyllur.
4. Nëse nuk ju gjendet shami në dorë, tështini ose kollituni në cep të bërrylit..

Të ngadalësojmë përhapjen e virusit



1. Mundohuni të mos jepni dorën, të përqafojeni kur doni të përshëndesni dikë
2. Tregoni kujdes për grupet në rrezik (njerëzit mbi moshën 65 vjeç, diabetikët, njerëzit me sëmundje të zemrës, të mushkërive ose të veshkave, ...
3. Fëmijët nuk sëmuren rëndë nga koronavirusi por mund ta përhapin atë lehtësisht
Prandaj, kontakti midis fëmijëve dhe të moshuarve, nuk rekomandohet.
4. Mbani distancën tuaj në vendet me shumë njerëz.
5. Shmangni kontaktin me njerëz të sëmurë dukshëm ose mbani një distancë të mjaftueshme.

Në rast se keni simptoma të gripit, ju lutemi, telefonojini mjekut tuaj. Mos shkoni as te mjeku dhe as në spital..



Temperaturë



Kollë



mbajtje fryme



fyt i skuqur



dhimbje koke

Masat e Qeverisë lidhur me koronavirusin hyn në fuqi në 18 mars ora 12h – 5 prill 2020 (duke përfshirë edhe 5 prillin)



www.info-coronavirus.be

STAY HOME SAVE LIVES

Daljet dhe lëvizjet

Qytetarët duhet të qëndrojnë në shtëpi, mund të dalin vetëm në rast se shkojnë në punë dhe për gjërat e domosdoshme siç janë: (farmacitë, dyqanet ushqimorë, karburantet, te mjeku, në postë, në bankë ose për të ndihmuar njerëzit në nevojë).

Aktiviteti në ajër të pastër rekomandohet por vetëm i shoqëruar nga një pjesëtar i familjes ose një shok me kushtin që të respektohet një farë distance. Grumbullimet e njerëzve janë rreptësisht të ndaluara.

Puna

Ndërmarrjet duhet të organizojnë punën në shtëpi për të gjitha funksionet për të cilat është e mundur. Për funksionet e tjera duhet të respektohen rregullat e distancës midis njerëzve.

Ato ndërmarrje të cilat nuk mund t'i respektojnë këto rregulla, duhet të mbyllen.

Në rast se një ndërmarrje nuk i respekton këto rregulla, mund të marrë gjobë të rëndë dhe në rast se e përsërit atë, mund edhe të mbyllet.

Këto masa nuk zbatohen për shërbimet kryesorë dhe të domosdoshëm.

Dyqanet

Dyqanet (duke përfshirë ata ushqimorë, farmacitë, dyqanet për kafshët dhe libraritë) duhet të mbyllen.

Hyrja është e kufizuar: një njeri për 10 m² dhe një kohë prej 30 minutash për të bërë pazaret.

Parukeritë mund të qëndrojnë të hapura me kushtin që të respektohet rregullisht, një klient sipas radhës dhe jo shumë njëherësh.

Dyqanet e natës mund të jenë të hapura deri në orën 22H gjithmonë duke respektuar rregullat.

Pazaret janë të mbyllura.

Dorëzimi i ushqimit në shtëpi është i mundur.

Të gjitha vendet kulturore dhe rekreative janë të mbyllura.

Transportet

Transportet publike duhet të garantojnë distancën sociale.

Udhëtimet jashtë Belgjikës që nuk konsiderohen si kryesore, janë të ndaluara deri në datën 5 prill 2020.

Shkollat

Mësimet janë pezulluar. Do të organizohet kujdes për ruajtjen e fëmijëve të paktën për fëmijët e stafit mjekësor dhe atij shëndetësor dhe të departamenteve të autoriteteve lidhur me sigurimin publik.

Për fëmijët që nuk kanë mundësi tjetër përveç se të ruhen nga persona të moshuar, prindërit mund të gjejnë gjithashtu një zgjidhje në shkolla.

Cerdhet janë të hapura

Shkollat e larta dhe universitetet, Vetëm mësimi në distancë lejohet.